



# AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT



## Projekti për Ishullin e Sazanit

Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me The Conservatoire du littoral dhe PIM Initiative organizuan një mision në ishullin e Sazanit. Misioni synonte realizimin e një plani menaxhimi të ishullit.

Plani i menaxhimit është i bazuar në një vizion:

"Për të ruajtur, të rivendosur dhe për të përmirësuar trashëgiminë kulturore të ishullit të Sazanit, duke siguruar përfitime të qëndrueshme ekonomike dhe ekologjike të komunitetit lokal në qarkun e Vlorës dhe zhvillimin e një qendre përkërkime shkencore, trajnime."

Misioni synon të realizojë një plan për identifikimin e ndërtesave për ti kthyer në zona mikëpritëse për publikun si edhe krijimin e një zyre menaxhimi dhe krijimin e Qendrës Bregdetare e Kërkimeve Shkencore.




## Studentë amerikanë në Tiranë

18 studentë nga Universiteti i Michigan në USA, prej disa janë në Shqipëri. Çdo ditë ata shohin diçka të re në Shqipëri, dhe plotësojnë raporte se kush vend mund të jetë një atraksion i vërtetë. Përvec kësaj, secili prej studentëve merr pjesë në një projekt nga ministri të ndryshme të Shqipërisë. E gjitha kjo për të përcjellë vlerat shqiptare në vendet e huaja, si edhe për të sjellë eksperiencën e tyre në Shqipëri.






## Projekti për rivitalizimin e “Via Egnatia”



Projekti parasheh : restaurimin, vendosjen e gurëve miliarë, ngritje të staneve (stacioneve) tradicionale, organizim karvanesh e jo vetëm. Projekti është miratuar nga qeveria shqiptare. Ende pa filluar implementimi i tij, interes i nga perëndimi është ngjalluar.




Gur miliar- Apolloni

Projekti i Via Egnatia do të zhvillohet në disa faza. Agjencia Kombëtare e Bregdetit parasheh që si fillim duhet bërë identifikimi historik i rrugës, për të vijuar me identifikimin e aseteve kulturore përgjatë saj.

Në projekt është përcaktuar edhe ngritja e stacionit kryesor të informimit të Via Egnatias në Durrës pranë Amfiteatrit, stacion ky që shënon dhe fillimin e itinerarit historik. Pos këtij stacioni një tjetër do të jetë edhe në Qafë-Thanë, për turistët që futen në Shqipëri nga kjo pikë doganore.

## Kthimi i “Via Egnatia” në atraksion turistik



Ende ka shumë gjurmë të kësaj rruge e cila është e gjatë 535 milje dhe e gjerë 30 këmbë u ndërtua me gurë dhe shërbente për transport udhëtarësh e mallrash. Rikthimi i kësaj rruge historike dhe me vlera trashëgimore në syrin e turistëve shqiptarë dhe të huaj do të ishte shumë interesante. Kjo është një ndër rrugët ku kultura e orientit është përplasur me atë të perëndimit. Mësohet se kjo rrugë ka qenë e rëndësishme në kohën e romakëve, gjatë periudhës së kryqëzatave, shumë apostuj të rëndësishëm kanë kaluar përgjatë saj dhe kanë predikuar fenë kristiane.



## Prag sezonit turistik, nis pastrimi i plazheve

Në prag të celjes së sezonit turistik 2015-të, Korpusi i Vullnetarëve dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit kanë nisur aksionin për pastrimin e plazheve të ndotura në vend, duke filluar nga plazhi i Spillesë, Kavajë.

Pastrimi i plazheve në të gjithë vendin do t'ju ofrojë të gjithë turistëve vendas apo të huaj pamjen e duhur të bregdetit shqiptar. Në bashkëpunim me ministrinë e Shëndetësisë janë marë masat për vendosjen e ambulancave mobile në zonat e plazheve, ndërsa po punohet intensivisht në të gjitha drejtimet për tu mundësuar vizitorëve pushime sa më të mira në Shqipëri.



## Punonjësit sezonale në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit


Agjencia e Bregdetit ka punësuar rreth 300 punitore sezonale. Punitoret do të ndahen në skuadra dhe do të punojnë intensivisht në pastrimin e plazheve më të mëdha të Shqipërisë. Aksioni i pastrimit të plazheve do të zgjasë gjatë gjithë sezonit veror.



## Vazhdon pastrimi i plazheve në vijën bregdetare

Në vazhdim të pastrimit të vijës bregdetare në pritje të nisjes së sezonit turistik, Agjencia Kombëtare e Bregdetit së bashku me mjetet e ushtrisë po vazhdojnë aksionin e pastrimit të zonës bregdetare në Sarande, Borsh, Shengjin dhe Golem. Kjo Agjenci ka nisur një bashkëpunim të gjerë me pushtetin vendor që bën pjesë në vijën bregdetare, duke nisur nga Velipoja deri në Ksamil, si dhe me ndihmën e mjeteve të ushtrisë.

Deri tani janë hequr një sasi e madhe mbetjesh urbane të lëna pas nga prishjet e objekteve pa leje gjate sezonit dimëror nga INUK, si dhe mbetje përgjatë rrugëve në zonat e plazheve pranë detit



## Baza ushtarake në Sazan bëhet atraksion turistik

"Pamjet e natyrës dhe imazhi shkëmbor të lënë pa frysme" raporton Daily Mail. Ky vend dikur i izoluar ka bukuri të rralla dhe kapacitetin të shndërrohet në njërin ndër vendet më të frekuentuara turistike gjatë verës. Gazeta e njohur britanike i ka bërë një reportazh ishullit të Sazanit në Jug të Shqipërisë.



Agjencia Kombëtare e Bregdetit Shqiptar ka planifikuar ta hapë ish bazën ushtarake të Ishullit Sazan si atraksion turistik këtë verë.

Ishulli i Sazanit ndodhet në ngushticën e Otrantos, në Jug të Shqipërisë, aty ku takohet deti Jon me atë Adriatik.

Teknikisht, ky vend është një bazë ushtarake, me dy marinarë dhe një bazë patrullimi, mirëpo kapaciteti i tij operacional nuk ka shkëlqimin që kishte dikur. Në të kaluarën, numri i trupave në bazë arrinte deri në 3000.

Dikur Ishulli ishte i izoluar, një vend i paarritshëm, një mister për pothuajse të gjithë shqiptarët, mund të kthehet në një vend atraktiv, sidomos për turistët e huaj.

Ky vend biodiversitar mund të tërheqë historianë dhe mund të bëhet destinacion i preferuar i zhytësve.

Ishulli ka disa llojeve të rralla të zogjve dhe zvarranikëve, kurse temperaturat bregdetare gjatë vitit luhaten nga 10 deri në 25 gradë.

Pamjet e natyrës dhe imazhi shkëmbor të lënë pa frysme.

Brenda ndërtesave të shkatërruara dhe të braktisura ka krevate të vjetra, enë kuzhine e madje edhe mjete shkolllore. Por, çuditërisht, pjesa më e madhe e shkatërrimit ka ndodhur pasi Shqipëria u bë demokratike.

Edhe pse për funksionalizimin e kësaj qendre turistike para se të vizitohet nga turistët nevojitet energjia elektrike dhe uji i pijshëm, planet për Sazanin janë të mëdha.





## Nis pastrimi i plazhit të Durrësit

Skuadra e pastrimit të Plazhit të Durrësit gati për një sezon më të mirë dhe më të pastër. Aksioni do të shtrihet përgjatë plazhit të Durrësit dhe do të zgjasij gjatë gjithë sezonit veror.



## Aksioni i pastrimit të plazhit të Golemit

Ka filluar aksioni i pastrimit të plazhit të Golemit i cili do të bëhet nga punonjësit sezonalë gjatë gjithë sezonit veror.



## Mbyllen dy kanale të ujërave të zeza në Golem

Agjencia Kombëtare e Bregdetit në fillim të sezonit turistik i ka dhënë zgjidhje një prej problemeve në plazhin e Golemit.

Pas një pune një javore, është mbyllur kanali i ujërave të zeza të rotondës. Në bashkëpunim me drejtorinë e ujërave, AKB filloi punën për mbylljen e një tjetër kanali të ujërave të zeza.

